




RAPORTI I DYTË NGA MONITORIMI I CILËSISË SË DEBATIT NË KUVEND



KUVENDI NËN THJERRËZ

Përforcimi i debatit politik
dhe diskursit deliberativ

TETOR 2014



RAPORTI I TRETË NGA MONITORIMI I CILËSISË SË DEBATIT NË KUVENDIN (TETOR)

Instituti për demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSCS) dhe Instituti për Evropën Lindore dhe Qendrore dhe Ballkanin (IELQB), duke filluar nga qershori i vitit 2014 deri në mars të vitit 2015 e përcjellin cilësinë e debatit në Kuvend. Monitorimi zhvillohet në kuadër të projektit “Kuvendi nën thjerrëz, përforsimi i debatit politik dhe të diskursit deliberativ” financiarisht i përkrahur nga Unioni Evropian.

Gjatë periudhës së monitorimit do të përgatiten dhjetë raporte mujore për cilësinë e debatit në Kuvendin. Para jush është raporti i tretë i tillë që ka të bëjë me debatin kuvendor në muajin tetor 2014.

Me aplikimin e “Indeksit për cilësi të debatit”¹ sipas disa parametrave vlerësohet veçmas çdo fjalim veçmas i pjesëmarrësve të seancave plenare dhe të seancave të tetë komisioneve kuvendore të zgjedhura sipas rëndësisë së tyre për debatin politik dhe kulturën politike në shtetin.

Qëllimi i monitorimit është që në mënyrë empirike, të fitohen njohuri se sa janë të argumentuara diskutimet në shtëpinë ligjvënëse dhe se sa qëndrimet e ndryshme merren parasysht dhe kontribuojnë në krijimin e ligjeve.

Në të njëjtën kohë, në kuadër të projektit realizohet edhe monitorimi i disa medimeve kombëtare² për tu parë se në çfarë mase opinioni është i njoftuar me esencën e debateve kuvendore dhe me përmbajtjen e argumenteve të shfaqura në seancat nga ana e deputetëve.

Pas çdo muaji të monitoruar opinioni do të informohet përmes raporteve për gjetjet kyçe nga monitorimi i debatit në Kuvendin dhe të informimit media nga puna e parlamentit.

A. REZYME

Gjetjet kyçe në Raportin e tretë të monitorimit (periudha e këqyrjes 1-31 tetor, gjithsej 11 seanca kuvendore) janë se diskutimi rreth propozimeve ligjore është ende i dobët, por deputetët kanë interaksion diç më të madh të ndërsjellë, krahasuar me periudhat paraprakisht të monitoruara (19 qershor – 31 korrik 2014 dhe 25 gusht -30 shtator).

¹ Indeksi për cilësi të debatit (Discourse Quality Index) është i krijuar nga një grup i teoricienëve prijës botëror demokracisë deliberative (debatuese). Indeksi paraqet metodologji e cila mundëson hulumtim empirik të cilësisë së debateve, forma dhe përmbajtja e të cilave, sipas teoricienëve, janë jashtëzakonisht të rëndësishme për demokracinë në një shoqëri. Indeksi gjatë viteve të fundit është përdorur për hulumtim të debatit në Parlamentin Evropian edhe në parlamentet e Gjermanisë, Zvicrës dhe në Kongresin amerikan.

² Monitorimi i medieve i përfshin televizionet kombëtare Sitel, Tellma, Alsat-M dhe RTM2 në gjuhën shqipe dhe gazetat Dnevnik, Sloboden pečat, Utrinski vesnik, Veçer, Koha dhe Lajm.

Projekti: Kuvendi nën thjerrëz, përforsimi i debatit politik dhe diskursit deliberativ. Projekti është i financuar nga Unioni Evropian



Thellimi i diskutimeve rreth një pjese të propozimeve ligjore në pjesën më të madhe ka të bëjë me rritjen e deputeteve në të cilat hyn një pjesë e madhe e replikave dhe të kundër-replikave. Interaksioni i shtuar pasqyrohet në numrin e shtuar të replikave dhe kundër-replikave rreth një pjese të propozimeve ligjore. Kjo mundësoi që opinioni për disa tema të përfitojë pikëpamje nga disa kënde.

Me këtë rast, tema për të cilat më së shumti e shkaktuan vëmendjen e deputetëve dhe për të cilat më së shumti u diskutua në tetor ishte Propozimi i plotësuar i Buxhetit për vitin 2015, seanca për pyetje të deputetëve (e para për këtë përbërje e Kuvendit), Raporti i Komisionit Evropian për përparimin në vitin 2014, Propozim ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për energjetikë dhe Propozim ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për zonat teknologjike-industriale.

Pikat e tjera nga rendi i ditës kaluan me diskutim të paktë ose të njëanshëm ose pa kurrfarë diskutimi.

Me këtë opinion sërish mbeti i varfëruar për debat cilësor për një pjesë të zgjidhjeve ligjore. Është lëshuar mundësia që përmes diskutimit të testohet vlefshmëria dhe qëndrueshmëria e argumenteve të prezantuara dhe mundësia që ato të kontestohen ose të plotësuara gjë e cila do të kontribuonte për sjellje të vendimeve më cilësore në favor të të mirës së përgjithshme dhe të interesit publik.

Karakteristike për këtë periudhë është që krahas mungesës së pjesës më të madhe të deputetëve të koalicionit opozitar të udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), deri më 20 tetor punën e parlamentit e bojkotuan edhe deputetët e opozitës nga Partia demokratike e Shqiptarëve (PDSH). Deputetët e PDSH pas 20 tetorit sërish morën pjesë në punën e Kuvendit.

Deputetët edhe në këtë periudhë mbetën “çdokush në istikamet e veta”. Më së shumti diskutuan çdonjëri për vetveten, përkatësisht përmes fjalimeve të tyre nuk arritën që të ç’bindin asnjë deputet që ta ndryshojë pozitën. Njëkohësisht, me këtë deputetët sërish nuk shfaqën interesim ose gatishmëri për ndryshimin e qëndrimeve të veta dhe të pozitive për shkak të argumenteve më të mira të shprehura nga deputetët e tjerë në debatin (“fuqia e argumentit më të mirë”).

B. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

“Indeksi i cilësisë së debatit” mundëson që çdo debat i veçantë i shfaqur në seancat të kodifikohet sipas disa karakteristikave kryesore:

- shkalla e argumentimit të fjalimit³;
- shkalla e respektit të folësit ndaj deputetëve të tjerë dhe argumenteve të tyre;
- çiltërsia për pranim të argumenteve të huaja dhe ndryshim të qëndrimeve të veta nën fuqinë e argumenteve të prezantuara në debatin;

³Nën shkallë të argumentimit merren parasysh numri i argumenteve me të cilat deputeti në fjalimin e tij i arsyeton pozicionet e veta duke mos hyrë me këtë rast në vërtetësinë ose vlefshmërinë e argumenteve. Me këtë rast nuk merren parasysh argumentet të cilat në mënyrë të qartë dhe pa dyshim janë nga tema e debatit.

Projekti: Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit politik dhe diskursit deliberativ. Projekti është i financuar nga Unioni Evropian



- nëse deputetët arsyetojnë se në emër të kujt dhe interesat e kujt i prezantojnë qëndrimet e veta;
- nëse deputetët mund pa pengesa ti shfaqin qëndrimet e veta dhe
- në çfarë mase është i pranishëm fjalori i pahijshëm.

Me monitorimin janë përfshirë debatet në trupat vijuese punuese në Kuvend:

- Seanca plenare;
- Komisioni për çështje kushtetuese;
- Komisioni për financa dhe buxhet;
- Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive;
- Komisioni për zgjedhje dhe emërime;
- Komisioni për vetëqeverisje lokale;
- Komisioni për çështje evropiane;
- Komisioni anketues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarit;
- Komisioni ligjvënës juridik.

C. KONTEKSTI POLITIK

Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi e ka pushtetin ligjvënës dhe është i përbërë nga 123 deputetë. Deputetët zgjedhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, përmes listave proporcionale zgjedhore për mandat prej katër vitesh. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura në prill 2014, partia Organizata e brendshme maqedonase revolucionare – Partia demokratike për unitet kombëtar maqedonas (OBMR-PDUK ose VMRO-DPMNE) fitoi 61 deputet, ndërsa partneri i tyre i koalicionit me të cilin ata e themeluan qeverinë, Bashkimi demokratik për integrim (BDI ose DUI), fitoi 19 deputetë. Nga një deputet në Kuvendin fituan partitë të Opsionit qytetar për Maqedoninë (GROM) dhe Rilindja demokratike kombëtare (NDP).

Deputetja e RDK Mirsada Emini e pranoi mandatin edhe përkundër vendimit të partisë RDK që ta bojkotojë Kuvendin dhe ju bashkëngjit grupit parlamentar të BDI.

Nga fillimi i monitorimit deri në botimin e raportit të parë, deputetët nga koalicioni më i madh opozitar të udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM ose SDSM), e cila në zgjedhjet fitoi 34 mandate, e bojkotojnë punën e Kuvendit⁴. Në periudhën e dytë të monitoruar (25 gusht – 30 shtator) pas incidentit në seancën e Komisionit për financa dhe buxhet, më 26 gusht, parlamentin e bojkotuan edhe shtatë deputetët e opozitës - Partisë demokratike shqiptare (PDSH). PDSH pas vendimit të trupave më të larta të partisë më 18 tetor vendosi që ta ndërpresë bojkotin e Kuvendit. Deputetët PDSH nga 20 tetori sërish marrin pjesë në seancat. Nga kjo datë në muajin tetor në Kuvend, nga

⁴Deputetet opozitare Roza Topuzovska Karevska nga Partia Liberale demokratike, Sollza Gërçeva dhe Lubica Buralieva nga LSDM vendosën ti pranojnë mandatet e deputetit të fituara në zgjedhje edhe përkundër vendimit të koalicionit opozitar për bojkot të punës së Kuvendit.

Projekti: Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit politik dhe diskursit deliberativ. Projekti është i financuar nga Unioni Evropian



pozitat opozitare vepronin vetëm tre deputetët nga koalicioni opozitar të LSDM të cilët vendosën ti pranojnë mandatet, ndërsa nga 20 tetori edhe 7-të deputetët e PDSH.


D. GJETJE NGA MONITORIMI

Ky raport e përfshin debatin në Kuvend në periudhën nga 1 deri më 31 tetor. Janë analizuar gjithsej 417 fjalime të pjesëmarrësve në debatet në gjithsej 11 seancë nga të cilat 8 janë plenare dhe 3 janë seanca të trupave punuese. Nga seancat e trupave punuese janë përcjellë nga një seancë e Komisionit për çështje evropiane, Komisionit ligjvënës-juridik dhe Komisionit për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive.

Nga këto fjalime, 297 janë të deputetëve në Kuvend, ndërsa 120 të pjesëmarrësve të jashtëm siç janë ministra, përfaqësues të ministrive dhe institucioneve të tjera shtetërore dhe publike. Në 11 seancë pjesëmarrësit në debatet janë shprehur për rreth 38 pika të rendit të ditës. Raporti ka të bëjë vetëm me fjalimet e deputetëve.

Në raport me karakteristikat demografike të diskutuesve, sipas:



- Seksit: 56% janë gra, ndërsa 44% janë burra.
- Përkatësisë etnike: 85% janë Maqedonas etnik, ndërsa 11% Shqiptarë etnik, 4% janë të tjerë.
- Arsimimit: 66% janë me arsim të lartë, 24% magjistra dhe 8% doktorë të shkencave.



Në seancat që u mbajtën në tetor vazhdoi trendi i rritjes së diskutimeve të deputetëve femra në debatet kuvendore. Deputetet, pa marrë parasysh se sipas numrit janë më pak se sa kolegët e vet burra, përkatësisht janë 35% nga numri i tërësishëm i deputetëve aktiv për momentin, në tetor ishin më aktive dhe ato kanë 56% nga të gjitha diskutimet. Nëse koha e tërësishme e diskutimeve të




monitoruara ndahet me numrin e diskutuesve ndahet sipas seksit të tyre, del se burrat mesatarisht kanë folur nga 6, ndërsa gratë nga 5 minuta.



Për shkak të kontekstit aktual në të cilin funksionon Kuvendi, pjesa më e madhe e folësve, sërish pjesa më e madhe e folësve (80%) i takojnë koalicionit në pushtet. Pjesëmarrja në debatet nga opozita nuk ndryshoi në raport me periudhën e kaluar, përkatësisht mbeti në 20%, gjë e cila në pjesë më të madhe ka të bëjë edhe me mungesën e deputetëve opozitar të PDSH nga Kuvendi deri më 20 tetor kur vendosën që ta ndërpresin bojkotin. Deri në atë datë, opozitën në Kuvend e përbënin vetëm tre. Prapëseprapë, pjesëmarrja e tyre sipas numrit të diskutimeve dhe sipas kohëzgjatjes së tyre është e konsiderueshëm duke pasur parasysh se nëse numri i tërësishëm i diskutimeve të deputetëve opozitar në tetor ndahet me numrin e tërësishëm të mandateve të pranuar nga opozita del se në çdo deputet opozitar në Kuvend vijnë nga mesatarisht 24 minuta diskutim. Nëse numri tërësishëm i diskutimit nga të gjithë deputetët nga shumica ndahet në numrin e tërësishëm të deputetëve nga koalicioni qeverisës del se çdo deputet nga shumica parlamentare në tetor mesatarisht ka diskutuar nga 16 minuta.




Kohëzgjatja e diskutimeve (e shprehur në minuta)



I. LLOJI I DISKUTIMEVE DHE INTERAKSIONI


Monitorimi në tetor sërish tregoi rritje të replikave midis pjesëmarrësve në debatet krahasuar me muajt paraprak. Në Tetor, nga numri i tërësishëm i diskutimeve, në 65% bëhej fjalë për diskutime veç e veç të deputetëve. Në replikat shkojnë 23%, ndërsa në kundër-replikat 12% nga diskutimet. Kjo tregon se deputetët për 8% më shpesh janë përgjigjur ose kanë komentuar në argumentet e diskutuesve të tjerë, në krahasim me periudhën paraprakisht të monitoruar (25 gusht – 30 shtator), ndërsa 16% më tepër se sa në periudhën e parë të monitoruar (19 qershor – 31 korrik). Kjo në një pjesë të caktuar ka të bëjë edhe me seancën e parë që ju kushtua pyetjeve të deputetëve në të cilën pyetjet dhe përgjigjet e deputetëve dhe të ministrave janë të koduara si replika.



Në këtë periudhë vërehet se më aktiv kanë qenë deputetët të cilat për momentin janë 33 nga gjithsej 92 deputetë në Kuvend. Të dhënat tregojnë se gratë në Kuvendin ndikojnë mbi thellimin e diskutimeve nëse kihet parasysh se në tetor ato dhanë 51% nga fjalimet individuale, 54% nga replikat dhe 86% nga kundër-replikat.




Pjesëmarrje në diskutimet sipas seksit të deputetëve



II. SHKALLË E ARGUMENTIMIT TË FJALIMIT

Nga fjalimet e monitoruara të deputetëve sipas Indeksit për cilësi së debatit, në 60% ekziston arsytimi i pozitive me dy ose më tepër argumente . Në 19% nga fjalimet është prezantuar një argument. Në 6% argumentimi ka qenë i dobët, ndërsa në 15% nuk është shfaqur kurrfarë argumentimi në diskutimin. Marrë në përgjithësi, në tetor shkalla e argumentimit është relativisht më e dobët se sa në dy periudhat e para të monitorimit. Deputetët më pak janë shërbyer me dy ose më tepër argumente në një diskutim (69% nga të gjitha diskutimet në periudhën 25 gusht - 30 shtator, krahasuar me 60% në tetor), ndërsa diç më tepër se me një argument (16% nga të gjitha fjalimet në tetor në periudhën 25 gusht - 30 shtator, krahasuar me 19% në tetor). Në plotësisht 15% nga të gjitha fjalimet në tetor nuk është përdorur asnjë argument. Në periudhat paraprake kjo ka ndodhur me 8% nga të gjitha diskutimet (25 gusht - 30 shtator) dhe 4% (19 qershor – 1 gusht).


Nëse dhe sa argumente përdoren në fjalimet?





III. FUQIA E ARGUMENTIT MË TË MIRË

Në seancat e monitoruara në tetor, gjithashtu si në periudhën paraprake, nuk është vërejtur se ndonjë deputet ka vënë në pah se e ndryshon pozicionin e vet me të cilin fillimisht është prezantuar në debatin për shkak të argumenteve më cilësore të prezantuara nga folësit e tjerë, ose për shkaqe të tjera. Përkundrazi, vërehet se është rritur përqindja e fjalimeve në të cilat deputetët nuk vështrojnë argumentet e prezantuara nga kolegët e tyre. Tani deputetët në 80% të diskutimeve aspak nuk i kanë vështruar argumentet të folësve të tjerë, gjë e cila është për 19% më tepër nga periudha paraprake kur vlerë ishte 61%. Në 5% të diskutimeve deputetët e kanë njohur vlefshmërinë e argumenteve të prezantuara nga pjesëmarrësit e tjerë në seancat, por nuk e kanë ndryshuar pozicionin e vet. Në pothuajse 15% të fjalimeve deputetët nuk e kanë pranuar vlefshmërinë e argumenteve të huaja dhe kanë mbetur në pozicionet e veta.




IV. RESPEKTIM NDAJ Pjesëmarrësve

Deputetët në tetor në kuadër të fjalimeve të veta në pjesën më të madhe ka shfaqur respekt themelor ndaj pjesëmarrësve të tjerë të seancave. Tani 63% nga deputetët kanë shfaqur respektim ndaj të tjerëve që është për 21% më pak se sa në periudhën e kaluar (25 gusht - 30 shtator) kur kjo u vërejt në 84% të diskutimeve. Për llogari të kësaj, ishin në mënyrë të konsiderueshme më të shpeshta fjalimet në të cilat diskutuesit nuk shfaqën kurrfarë raporti ndaj të pranishmëve, përkatësisht 33%. Periudha e kaluar e monitoruar të tillë ishin vetëm 8% nga numri i tërësishëm i diskutimeve. Në 1% të diskutimeve është shprehur mos-respektim ndaj personaliteteve të pjesëmarrësve të tjerë në seancat.




Raport ndaj pjesëmarrësve



V. RESPEKTIM NDAJ ARGUMENTEVE


Deputetët në seancat e monitoruara në tetor sërish në masë shumë më të vogël ishin të disponuar të shfaqin respektim ndaj argumenteve të folësve të tjerë krahasuar me periudhën e kaluar. Ajo ka ndodhur në vetëm 15% të paraqitjeve të tyre, që është për 46% më pak nga periudha e kaluar e monitoruar kur deputetët në 61% të diskutimeve shfaqën ndaj argumenteve të të tjerëve. Respektim eksplicit është shfaqur në 4% të fjalimeve. Në 2% folësit shfaqën mos-respektim të pjesshëm ndaj folësve të tjerë, ndërsa në pjesë më të vogël kanë pasur sjellje neutrale. Mos-respektim të plotë ndaj argumenteve të huaja ka pasur në 5% të fjalimeve. Në 6% të diskutimeve është shfaqur respektim i pjesshëm që do të thotë se folësit në masën më të madhe kanë pasur raport neutral, ndërsa në pjesën më të vogël të diskutimeve të veta kanë shfaqur mos-respektim ndaj argumenteve të folësve të tjerë. Më shumë diskutime me elemente të mos-respektimit ndaj argumenteve të folësve të tjerë janë vërejtur në seancën në të cilën u debatua për Propozimin e plotësuar të Buxhetit për vitin 2015.

Në diskutimet në tetor, deputetët më shpesh janë përmbajtur që të shfaqin ndonjë lloj raporti ndaj argumenteve të diskutuesve të tjerë për dallim nga periudha paraprake. Kështu, në 68% të diskutimeve nuk kanë shfaqur kurrfarë raporti ndaj argumenteve të tjera për dallim prej 30% nga periudha e monitoruar e kaluar. Në seancën për pyetje të deputetëve, deputetët në mënyrë më të shpeshtë nuk kanë shfaqur kurrfarë raporti ndaj argumenteve të folësve të tjerë (72%).



VI. VËLLIMI I ARSYETIMEVE DHE TË NDËRPRERJEVE

Pjesëmarrësit në debatet parlamentare në pjesën më të madhe, përkatësisht në 76% të fjalimeve, janë thirrur në atë se pozitat dhe qëndrimet e tyre janë në drejtim të të mirës së përgjithshme dhe interesave të të gjithë qytetarëve. Në 13% të fjalimeve, deputetët janë thirrur në atë s, deputetët janë thirrur në 7% të rasteve. Në vetëm 1% të fjalimeve janë vërejtur ndërprerje të shkurtra.



VII. GJUHA E PAHIJSHME

Në pikëpamje të gjuhës së pahijshme, pjesëmarrësit në debatet e monitoruara kuvendore në këtë periudhë në përgjithësi janë përmbajtur nga përdorimi i saj. Në 98% të diskutimeve të monitoruara nuk është vërejtur gjuha e pahijshme. Në tetor në seancat e monitoruara nuk është vërejtur rast i kufizimit të deputetëve gjatë fjalimeve të tyre nga foltoret.



E. KONKLUZIONE:

- Diskutimi në Kuvend në periudhën e tretë të monitoruar (tetor) në pjesën më të madhe karakterizohej me fjalime individuale të deputetëve dhe interaksion diç më të madh të pasqyruar përmes numrit të shtuar të replikave midis pjesëmarrësve krahasuar me periudhat paraprakisht të monitoruara (19 qershor – 1 gusht dhe 25 gusht – 30 shtator).
- Deputetet gra sërish e rritën pjesëmarrjen në diskutimet dhe tek ata është merita për thellimin e debateve rreth një pjese të propozimeve ligjore duke e pasur parasysh se ato i dhanë numrin më të madh të replikave dhe kundër – replikave në seancat e monitoruara.
- Diskutimi rreth numrit më të madhe të propozimeve ligjore në përgjithësi mbetet i dobët dhe nuk mundëson që përmes debatit publik të testohet vlefshmëria dhe qëndrueshmëria e argumenteve të përgatitura dhe të shfaqura të deputetëve. Mundësia që argumentet të kontestohen ose të plotësohen është lëshuar dhe me këtë publiku është i varfëruar për pikëpamjet e ndryshme të cilat do të kontribuonin për përpilimin e vendimeve më cilësore në favor të të mirës së përgjithshme dhe të interesit publik.
- Fjalimet e analizuar në periudhën e monitoruar, në pjesën më të madhe janë të mbështetura me dy ose më tepër argumente. Prapëseprapë, përqindja e diskutimeve të argumentuara në atë mënyrë ka rënë në mënyrë të butë në krahasim me muajt e kaluar, ndërsa është rritur përqindja e diskutimeve me një argument si edhe rastet kur folësit e kanë marrë fjalën, por nuk kanë shfaqur kurrfarë argumentesh.
- Pjesëmarrësit në seancat e monitoruara nuk treguan interes dhe gatishmëri për ndërrim të qëndrimeve për shkak të argumenteve më cilësore të prezantuara në debatin.
- Në raste të rralla, në 2% deputetët kanë përdorur gjuhë të pahijshme.

Projekti “Kuvendi nën thjerrëz, përforcimi i debatit publik dhe diskursit deliberativ” është i financuar nga Unioni Evropian.

Ky publikim është i përgatitur me ndihmë të Unionit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e Institutit për demokraci “Societas Civilis” – Shkup (IDSCS) dhe në kurrfarë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i shfaq pikëpamjet e Unionit Evropian.